



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 Shkodër/ Te çitëna në bjeshkët e Munellës! 37-vjeçar: Kemi konflikt me një bashkëpunëtor, gjeta tabelë me mbishkrimin 'ik se do vdesësh!' Policia gjen 6 gjezhoja



2 Pukë, çpëtohen 2 turistë holandeze në Majën e Murgës! Emnuesi Pjetri apelon: Mos merrni malet pa udhërrëfyes



3 Sulmoi 'live' godinën e bashkisë Korçë, arrestohet ish-futbollisti dhe repëri i njohur si 'Çekiçi' 14



4 Mbyllet faza e parë e aksionit për sigurinë ushqimore, Tatimet 103 ton mallra të bllokua në 20 ditë



5 Një akademi për 'barinjte' e hoteleve që duan turizëm elitari por shpërbëjnë si lopëçar

Kronikë

Plagosja e të riut në Fresk, në kërkim autori dhe bashkëpunëtori! 1 në pranga

Policia e Tiranës ka shpallur në kërkim autorin e plagosjes së të riut në Fresk. Njëri prej bashkëpunëtorëve u arrestua, ndërsa tjetri është shpallur në kërkim.



Policia e Tiranës



Redaksia 3 Gusht, 12:12 | Përditësimi: 3 Gusht, 12:39



TIRANË- Një ditë pas **plagosjes me armë** të 27-vjeçarit Juglen Abazi në Fresk, Policia ka identifikuar autorin e ngjarjes. Burime zyrtare bëjnë me dije se është shpallur në kërkim autori 27-vjeçar **Klevis Caka** (Lusha). Ndaj tij rëndojnë akuzat "Vrasje me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit".

Po ashtu blutë kanë identifikuar edhe dy bashkëpunëtorët e tij, të cilët dyshohet se e kanë ndihmuar autorin të largohet nga vendi i ngjarjes. Njëri prej tyre është arrestuar, **Xhonatan Qerimi** 27 vjeç, ndërsa në kërkim është shpallur Andi Gurra 26-vjeç. Arsyeja e plagosjes dyshohet të ketë qenë sherri për një vajzë.

"Në vijim të veprimeve intensive hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e djeshme, në rrugën "Thoma Filipeu", në Fresk, ku mbeti i plagosur me armë zjarri 28-vjeçari J. A., specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda kundër Jetës dhe Pronës kanë identifikuar autorin e dyshuar dhe dy bashkëpunëtorët e tij.



LEXO EDHE:
The National: Tirana në 48 orë, vizitoni atraksionet kryesore të kryeqytetit plot jetë të Shqipërisë

Në vijim të veprimeve procedurale: -U shpall në kërkim autori i dyshuar i plagosjes, shtetasi K. C. (L.), 26 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Vrasje me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit";

-U arrestua në flagrancë shtetasi Xh. Q., 27 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Përkrahje e autorit të krimit"; U shpall në kërkim shtetasi A. G., 26 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Përkrahje e autorit të krimit". Nga veprimet hetimore dyshohet se shtetasit Xh. Q. dhe A. G. kanë ndihmuar autorin e dyshuar të largohet nga vendngjarja", njoftoi Policia e Tiranës.

Ndërkohë, 27-vjeçari i plagosur u paraqit vetë në spitalin e Traumës për të marrë ndihmë mjekësore.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Juglen abazi Xhonatan Qerimi Andi Gurra Klevis Caka Tirane

Komento

Komente



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

3 Gusht, 06:37

Çfarë mendoni për ndryshimet e propozuara me draftin për Kodin e ri Penal?

Jam pro

Jam kundër


Nuk kam mendim

Lajme të tjera




Pas Selitës, deputeti Erion Braçe denoncon të tjera PAMJE në Tiranë: Te pallatet 'Agimi' mbeturinat në rrugë, na dëmton! Si u lëvizën koshat?

2 Gusht, 22:13



Tiranë/ Plagoset me armë te 'Fresku' 27-vjeçari, shkon vetë në spital! Policia nis hetimet për shkaqet dhe rrethanat

2 Gusht, 20:38



Ndihej lëkundje sizmike në Shqipëri, ja ku ishte epiqendra dhe sa ishte forca e tërmetit!

2 Gusht, 17:05



Kulla në Farkë, PL: Pa konsultim publik dhe pa transparencë

2 Gusht, 15:04



Vëzhgimi i Report Tv/ Lavazhet mes lagjeve në Tiranë vijnë punën! Qytetarët: Qeveria t'i largojë, vendim i duhur (VIDEO)

1 Gusht, 17:26



Dosja 5D/ Kërko ndryshimin e masës së sigurisë, GJKKO rrëzon kërkesën e ish-drejtorit të bashkisë Tiranë

1 Gusht, 13:29



Tiranë/ Shpërndanin kokainë dhe hashash në kryeqytet, 5 të arrestuar në pak orë! (EMRAT+VIDEO)

1 Gusht, 13:22



'Llogorja e Antiligjit', Rama: Gjyqtari Hazbi Balliu i pacipë, 'çlirroi' pallatin e konfiskuar në mes të Tiranës

1 Gusht, 11:53



Kavajë/ Ndezën zjarr në Gosë e Luz të madh Madh, nis hetimi për 2 persona (EMRAT)

1 Gusht, 10:12



VKM/ Pallati i Kongreseve i kalon në administrim ministrisë së Ekonomisë për projektin e 'Rivitalizimit'

31 Korrik, 20:38



Kontrolltet në banesa e biznese, Apeli i Posaçëm rrëzon ankimin e Arbër Veliajt

31 Korrik, 12:44



I dënuar me 4 vjet e 8 muaj burg, për kultivim të bimëve narkotike, 43-vjeçari në Krujë (EMRI)

31 Korrik, 11:18